



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 01.10.2024

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kamion me çisternë për transport lëndë të ndryshme (ujë) për Drejtorinë e MZSH-së”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodit CPV: Autocisterna 34223200-8 .

VLERA E FONDIT LIMIT: 13.747.222 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e dy) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrat të grupit të Specifikimeve nr.285, datë 23.08.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kamion me çisternë për transport lëndë të ndryshme (ujë) për Drejtorinë e MZSH-së”.

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, si dhe neni 42 sipas të cilit:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon:

- çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

d. çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.

Grupi u mbështet: Në studimin e tregut vendas, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e disa subjekteve vendas.

Grupi i punës u konsultua respektivisht me operatore ekonomike që operojnë në fushën e objektit të prokurimit.

Pas shqyrtimit të të dhënave dhe informacionit të mbledhur, mbështetur në rezultatin e sipërnxjerrë rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 13.747.222 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e dy) Lek pa TVSH.

Garancia e mallit sipas specifikimeve teknike.

Afatet e lëvrimit: 45 (dyzet e pesë) ditë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 13.000.000 lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri

audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Dokumentet e kërkuara me sipër, do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 5.000.000 lek. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 40 pika 4, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i:

- Certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalente e tij. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 OE duhet të paraqes një deklaratë në të cilën merr përsipër që mjetet e ofruara janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Ky kriter permbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të ilustronin mjetet e ofruara prej tyre dhe të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, nenin 45, Seksioni III “Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:

*“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomike më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, brenda afatit 7 ditë që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas nenit 97/1 të LPP-së, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhtme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al
Ueb-faqe	www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Mall.

3. Numri i referencës së procedurës/Lotit: REF- 22294-10-01-2024.

4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “Blerje kamion me çisternë për transport lëndë të ndryshme (ujë) për Drejtorinë e MZSH-së”.

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodit CPV: Autocisterna 34223200-8.

6. Fondi limit: 13.747.222 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e dy) Lek pa TVSH.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 45 (dyzet e pesë) ditë.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 17.10.2024, ora: 10:00.

9. Procedurë e Rishpallur:

Po ☒ **X** **Jo** ☐

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit:
REF-02947-04-29-2024

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit: “Blerje kamion me çisternë për transport lëndë të ndryshme (ujë) për Drejtorinë e MZSH-së”.

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit: 13.747.222 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e dy) Lek pa TVSH.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit